



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.369-2/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj, kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me kërkesën për rishqyrtim Anr.369-4/2025, të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër vendimit të PZAP-it Anr.369/2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 11.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar kërkesa Anr.369-4/2025 e datës 09.02.2025, e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar rishqyrtimin dhe anulimin e vendimit të PZAP-it, A.nr.369/2025, datës; 07.02.2025, me të cilin i është shqiptuar dënimi më gjobë në lartësi prej 3,000.00 euro, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Paneli me Vendimin Anr.369/2025 të datës 07.02.2025, subjektit ankues i ka shqiptuar dënim më gjobë në lartësi prej 3,000.00 euro, në emër të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

PZAP-i, me datë 09.02.2025, ka pranuar kërkesën për rishqyrtimin e vendimit Anr.369/2025, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendohet se për rastin A.nr. 369/2025, z. Kolgeci rithekson faktin përcaktues në këtë çështje se vizita e tij nuk ka pas thirrje për votim, nuk ka as logo të partisë, as slogan zgjedhor, as numër të kandidatit, ka qene thjesht vizite nga roli i qytetarit e besimtarit të fesë islame, krejt miqësore andaj mos administrimi i duhur i këtij argumenti ka sjell deri të vendimi gjobites.

Andaj, për rastin e lartcekur lusim PZAP qe të ri administroj provat e faktet e cekur dhe mbi bazën e tyre të marr vendime meritore, qofte anulime të vendimit tërësisht, qofte pjesërisht varësisht argumentit.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se:

Kërkesa për Rishqyrtim dhe anulimin e vendimit Anr.369/2025, e datës 09.02.2025, është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës përkatësisht kërkesa Anr.369-4/2025, e datës 09.02.2025 për rishqyrtimin e vendimit rrjedh se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e parashtruara në kërkesë, kjo për faktin se PZAP-i, pas shqyrtimit të kërkesës erdhi në përfundim se nuk kemi të bëjmë me prezentimin e fakteve të reja respektivisht.

Ndërsa duke vlerësuar pretendimet sipas kërkesës për rishikim se vizita e z. Kolgeci nuk ka pas thirrje për votim, nuk as logo të partisë, as slogan se vizita ka qene miqësore, sipas bindjes se panelit pretendimi i tille është i pabazuar. Qëndron fakti se në fotot e postuara nga Selman Kolgeci nuk ka simbole, slogane apo logo të partisë- subjektit politik LDK mirëpo nuk është kontestuese se vizita është realizuar në Bashkësinë Islame në Suhareke sepse vet kandidati për deputet z. Kolgeci në rrjetin social ka bere me dije se kane realizuar vizite në kohe fushate në bashkësinë islame në Suhareke, andaj nuk është kontestuese se një vizite e tille e realizuar gjate fushatës ka për qellim elektorale.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura vendimi i kontestuar me kërkesë për rishikim, rezulton të jetë i drejtë, i ndërtuar mbi fakte, prova dhe i mbështetur në dispozitat ligjore në fuqi.

Në rastin konkret subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, kërkesën për rishikim të vendimit nuk e ka mbështetur në asnjë provë apo fakt të ri, që do ta bind panelin që të njëjtën kërkesë ta aprovojë si të bazuar.

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e lartcekura vendosi që kërkesën për rishqyrtim të refuzojë si të pabazuar në kuptim të nenit 118 paragrafin 4 e lidhur me nenin 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.369-2/2025, datë; 11.02.2025

Kryesues i Panelit
Skender Gogaj



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*